



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax:
E-Mail: info@dpa.gov.al

Politika për akreditimin ndër-kufitar

Kodi DA-PO-012

Rishikim nr 4
Data: 08.06.2022

Faqe 1 nga 5

Politika për akreditimin ndër-kufitar

1. Fusha e aplikimit

Ky dokument përcakton politikën e DPA mbi akreditimin ndër-kufitar, akreditimin e dëgëve dhe vendndodhjeve kritike të organeve të vlerësimit të konformitetit të rregjistruara në Shqipëri dhe akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA që lëshojnë raportet e testimit, kalibrimit dhe certifikatat e certifikimit apo inspektimit jashtë territorit të Shqipërisë, duke marrë në konsideratë politikat dhe legjislacionin ndërkombëtar.

2. Referencat:

- EA Politika ndërkufitare, EA-2/13:2019
- ILAC Politika ndërkufitare, ILAC G 21-09:2012
- IAF MD 12:2016 Vlerësimi i akreditimit të organeve të vlerësimit të konformitetit me aktivitet në disa shtete.
- IAF MD 23 Kontrolli i entiteteve që funksionojnë në emër të organeve certifikuese të sistemeve të menaxhimit të akredituara.
- ISO/IEC 17011:2017 “Vlerësimi i konformitetit– Kërkesa për organizmat akreditues që akreditojnë organe të vlerësimit të konformitetit”.
- Rregullorja 765/2008 “Kërkesa për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut për tregtimin e produkteve”
- Ligji nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.
- IAF MD 2:2017 “Transferimi i Certifikimit të sistemeve të menaxhimit i akredituar”.

3. Politika Ndërkufitare

Politika e DPA është që të kontribojë në zhvillimin e akreditimit në Rajon, Europë dhe në Botë. DPA ofron shërbimin e akreditimit tek organet e vlerësimit të konformitetit si një aktivitet jo fitimprurës.

Është politikë e DPA që të mos promovojë shërbimin e akreditimit në vendet ku ekzistojnë organizmat kombëtare të akreditimit. DPA nuk konkuron me organizmat kombëtare akreditues në vendet e tjera.

DPA mund të ofrojë shërbimin e akreditimit tek organet e vlerësimit të konformitetit të rregjistruara ligjerisht në një shtet tjetër vetëm në përputhje me kriteret e vendosura në nenin 8 të Ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax:
E-Mail: info@dpa.gov.al

Politika për akreditimin ndër-kufitar

Kodi DA-PO-012

Rishikim nr 4
Data: 08.06.2022

Faqe 2 nga 5

Nëse DPA akrediton një organ të vlerësimit të konformitetit në një shtet tjetër, për shkak të mungesës së kompetencës teknike apo mosfirmosjes së marrveshjeve të njohjes reciproke të organizmit kombëtar të akreditimit të këtij shteti, DPA njofton organin e vlerësimit të konformitetit që ai duhet të transferojë akreditimin tek organizmi akreditues kombëtar i shtetit të tij menjëherë sa kushtet të ndryshojnë. Në këtë rast DPA nuk do të iniciojë një cikël të ri akreditimi ose të zgjerojë fushën e akreditimit nëse kushtet kanë ndryshuar. Në cdo rast rivlerësimi, DPA do të verifikojë nëse kushtet për ofrim të akreditimit tek një OVK në një shtet tjetër plotësohen.

Kur DPA akrediton një OVK të rregjistruar në Shqipëri, kundrejt një rregulloreje të huaj, DPA do të sigurojë kompetencën e nevojshme në bashkëpunim me organizmin akreditues të vendit që ka lëshuar këtë rregullore.

Kur organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA krijojnë degë ose vendndodhje kritike në shtete të tjera ose kryejnë veprimtari të vlerësimit të konformitetit në shtete të tjera, nën akreditimin e DPA, kur është e mundur DPA nenkontraktin organizmin akreditues të këtyre shteteve për vlerësimin e tyre duke përfshirë edhe vlerësimet me dëshmi që kryhen në shtetin tjetër në rast se organizmi akreditues i shtetit tjetër është nënshkruar i EA MLA, ILAC MRA ose IAF MLA. Nënkontraktimi mund të mos zbatohet edhe në rastin kur organizmi akreditues i shtetit tjetër refuzon kryerjen e vlerësimit në emër të DPA. Në rastin kur organizmi akreditues i shtetit tjetër nuk pranon të kryejë vlerësimin ose kur ai nuk është anëtar i EA MLA, ILAC MRA ose IAF MLA, DPA nuk do ta nënkontrakttojë organizmin akreditues, por do të kërkojë që përfaqësues të këtij organizmi të jenë të paktën vëzhgues.

Organet e vlerësimit të konformitetit të cilët janë të akredituar nga DPA mund të dëshirojnë të lëshojnë raporte apo certifikata me simbolin e DPA në vendet e tjera jashtë Shqipërisë në këto kushte:

- Shtetet në të cilat raportet ose certifikatat e akredituara janë lëshuar nga zyra qendrore e OVK-së ose nga degë të saj që janë nën akreditim dhe,
- Shtetet në të cilat OVK operojnë dhe në të cilat kryhet një ose më shumë aktivitete kritike pavarësisht nga marrëdhënia ligjore e këtyre degëve me zyrën mëmë të OVK.

4) Kriteret për akreditim për organet e vlerësimit të konformitetit me vendndodhje në disa shtete

4.1 Kur një OVK është subjekt i rregjistruar në Shqipëri dhe e akredituar nga DPA ka vendndodhje të tjera jashtë Shqipërisë, ajo mund të kërkojë nga DPA një akreditim që



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax:
E-Mail: info@dpa.gov.al

Politika për akreditimin ndër-kufitar

Kodi DA-PO-012

Rishikim nr 4
Data: 08.06.2022

Faqe 3 nga 5

mbulon aktivitetet për të gjitha vendndodhjet e saj. Kushtet që kushtet duhet të plotësohen dhe zbatohen pavarësisht nga statusi juridik i vendndodhjeve janë:

4.1.1 Akreditimi që mbulon shumë vendndodhje është i mundur vetëm kur të gjitha aktivitetet mund të bien nën përgjegjësinë e një personi të vetëm juridik. Kur vendndodhjet individuale që mbulojnë nga akreditimi kanë gjithashtu personalitet juridik të ndryshëm, pritet që keto subjekte juridike të jenë të lidhura dhe të formojnë pjesë të së njëjtës organizatë .

Përgjegjësia duhet të demonstron në bazë të marrëveshjeve kontraktuale ose marrëveshje të tjera ligjore ndërmjet subjektit të akredituar dhe vendndodhjet e tij dhe të rregullore të brendshme në vendndodhjet që specifikojnë këto marrëdhënie në drejtim të menaxhimit dhe përgjegjësive.

4.1.2 Certifikata e akreditimit dhe programi i akreditimit i lëshuar OVK nga DPA do t'i referohet vetëm subjektit ligjor të kësaj OVK i cili është përgjegjës për aktivitetet e akredituara të vlerësimit të konformitetit të kryera në të gjitha vendndodhjet e tij.

4.1.3 Të gjitha vendndodhjet që do të përfshihen në akreditimin e OVK-së duhet të funksionojnë nën të njëjtin menaxhim dhe të njëjtin sistem menaxhimi.

4.1.4 Subjekti ligjor i regjistruar (OVK) duhet të demonstrojë se ka kontroll mbi dhe monitoron aktivitetet në vendndodhjet e tij. Subjekti ligjor i regjistruar duhet të jetë në gjendje demonstrojë se një kontroll dhe monitorim i tillë është i vendosur dhe funksionon siç duhet.

4.1.5 Kur vendndodhjet individuale janë subjekte ligjore të ndryshëm nga ai i OVK-së së akredituar ata nuk do të ofrojnë shërbime të akredituara në tregun e tyre lokal nën entitetin e tyre juridik vendas pasi ky person juridik vendor nuk është brenda fushës së akreditimit të dhënë nga DPA.

4.1.6 Subjekti ligjor i OVK-së së akredituar mban përgjegjësinë për aktivitetet e kryera nga vendndodhjet e tij të mbuluara nën objektin e akreditimit të tij.

4.1.7 Vendndodhjet individuale të OVK-së mund të ofrojnë aktivitete të vlerësimit të konformitetit tregut lokal vetëm në emër të OVK-së së akredituar. Certifikatat dhe raportet e lëshuara sipas akreditimit të dhënë nga DPA do të përmbajnë emrin dhe adresën e subjektit juridik të akredituar pa iu referuar emrit ose logos së ndonjë OVK-je lokale. Citimet, kontratat, certifikatat dhe raportet e lëshuara nuk duhet të krijojnë asnjë konfuzion për subjektin ligjor të OVK-së që mban akreditimin.

4.2 Parimet e akreditimit ndër-kufitar me shumë vendndodhje kërkojnë që OVK dhe vendndodhjet e përfshira brenda programit të akreditimit duhet:



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax:
E-Mail: info@dpa.gov.al

Politika për akreditimin ndër-kufitar

Kodi DA-PO-012

Rishikim nr 4
Data: 08.06.2022

Faqe 4 nga 5

1. OVK do të bashkëpunojë plotësisht me DPA dhe organizmat akreditues të vendeve të përfshira.
2. Vendndodhjet individuale nuk mund të refuzojnë pjesëmarrjen në vlerësim, proceset e rivlerësimit dhe monitorimit të organizmit akreditues të vendit tjetër.

Kur pranohen aplikimet për akreditim, DPA duhet të sigurohet që aplikanti është vënë në dijeni dhe i pranon këto kushte.

4.3 Nëse një vendndodhje hiqet nga lista e vendndodhjeve të dhëna në programin e akreditimit, p.sh. për mosplotësim të kërkesave, DPA do të përcaktojë ndikimin në statusin e programit të plotë të akreditimit. Në këtë drejtim, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet kërkesave për OVK për kontrollin dhe monitorimin e aktiviteteve (4.1.4) dhe për marrjen e përgjegjësisë për aktivitetet e kryera 4.1.6).

4.4 Është përgjegjësi e DPA të hartojë programin e vlerësimit për të mbuluar aktivitetet, vendndodhjet dhe personelin që do të vlerësohen në përputhje me procedurën “Përgatitja për vlerësim dhe teknikat e vlerësimit” duke marrë parasysh rrezikun që lidhet me aktivitetet dhe kushtet e tregut në secilën vendndodhje.

Analiza e rrezikut do të rishikohet në bazë të të dhënave nga organizmat akreditues të vendeve të tjera duke u mbështetur në njohuritë dhe ekspertizën e tyre për tregjet dhe rregulloret e tyre përkatëse. Në përcaktimin e teknikës së vlerësimit dhe vlerësimit të konformitetit që do të vlerësohet do të merren parasysh:

:

- Rregullore të ndryshme vendore
- Njohuri për tregun vendor
- Vëllimi i punës së kryer nga OVK në vendndodhje të ndryshme
- Ndikimi i aktiviteteve të OVK të kryera nën akreditimin e DPA në tregjet lokale p.sh. pjesa e tregut të mbajtur nga OVK
- Historiku i rezultateve të vlerësimit të aktivitetit të vlerësimit të konformitetit dhe/ose vendndodhje
- Niveli i kontrollit dhe monitorimit i demonstruar nga OVK për çdo vendndodhje të caktuar
- Nëse zyra lokale ka apo jo akreditim nga organizmi akreditues i vendit tjetër për të njëjtën program të akreditimit ose të ndryshëm dhe/ose përdor të procese të njëjta ose të ndryshme të vlerësimit të konformitetit dhe/ose operojnë sistem menaxhimi të njëjtë ose të ndryshëm.
- Aty ku vendndodhja ka akreditim nga organizmi akreditues i vendit tjetër, cikli/frekuenca e vlerësimit nga organizmi akreditues i vendit tjetër duhet të përdoret sa më shumë që të jetë e mundur



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax:
E-Mail: info@dpa.gov.al

Politika për akreditimin ndër-kufitar

Kodi DA-PO-012

Rishikim nr 4
Data: 08.06.2022

Faqe 5 nga 5

5) Detyrimet e aplikuesve dhe organeve të vlerësimit të konformitetit të akredituar nga DPA.

- Cdo fillim viti OVK e akredituara që kanë lëshuar raporte/certifikata të akredituara jashtë Shqipërisë, duhet të raportojnë për këtë aktivitet tek DPA.
- Aplikuesit duhet të paraqesin tek DPA të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e aktivitetit të tyre jashtë Shqipërisë. Në rast se ky aplikues e ka kryer këtë aktivitet më parë atëherë ai duhet të paraqesë në DPA një raport të aktivitetit të tij jashtë Shqipërisë.
- Në rastet e zgjerimit të fushës së akreditimit me vendndodhje kritike ose degë, OVK e akredituar duhet të paraqesë në DPA të gjithë dokumentacionin që DPA kërkon të paktën dy muaj përpara vizitës mbikëqyrëse të planifikuar.
- Organet e certifikimit të sistemeve të menaxhimit duhet të raportojnë mbi numrin e certifikatave të transferuara nga organet e tjerë certifikues nga një vit më parë.
- Organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit zbatojnë DA-IN-009.

Data: 08.06.2022

Drejtori i Përgjithshëm
Armond HALEBI